



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **ZYRA E KRYETARIT**

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja n) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore, dhe neneve 16, 19 paragrafi 14 dhe nenin 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Raportit/rekomandimit (*nr.prot.02-024/01-0030701 datë 24.06.2020*) të Komisionit për shqyrtimin të OJQ-ve për licencim si Qendra Rinore Publike i themeluar nga Kryetari i Komunës me Vendimin nr.prot.02-020/04-0085534/19 datë 04.11.2019,

Në pajtim me Shkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, nxjerrë,

### **VENDIM**

### **PËR LICENCIMIMIN E OJQ “LIDHJA RINORE BLUE”, SI QENDËR RINORE PUBLIKE NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim, Licençohet OJQ “Lidhja Rinore Blue”, si Qendër Rinore Publike në Komunën e Podujevës.

#### **Neni 2**

OJQ sipas nenit 1 licençohet, ndër të tjera, me qëllim të ofrimit të hapësirës dhe mundësive për aktivitetet dhe veprimtarive programore të të rinjve si dhe mundësive për zhvillimin e veprimtarive edukative joformale dhe veprimtarive të tjera të planifikuara nga të rinjtë, bashkëpunimin me OJQ tjera në aktivitete të përbashkëta dhe pjesëmarrje në procese të vendimmarrjes, si dhe çështje tjera të parapara me legjislacionin përkatës në fuqi.

#### **Neni 3**

OJQ “Lidhja Rinore Blue” licençohet për periudhën 4 (katër) vjeçare.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### **u dërgohet;**

- Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
- OJQ-së, “Lidhja Rinore Blue”
- Arkives

**Nr.prot. 02-020/04-0030781/20**  
**Podujevë,**  
**24 qershor 2020**



**Nënkyetari i Komunës**  
**Nexhmi Rudari**